



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**LIGJ**

**Nr. 92/2018**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË  
MAQEDONISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN PËR PROGRAMIN  
E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II,  
ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË - REPUBLIKA  
E SHQIPËRISË, 2014-2020, ALOKIMET E VITIT 2017**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 3.12.2018

